



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 15, datë 28.02.2023**

**PËR  
MIRATIMIN E AUDITUESIT LIGJOR “HOLLY & ENDI AUDITING” SH.P.K., PËR  
AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË BYROSË SHQIPTARE TË  
SIGURIMIT, PËR VITIN FINANCIAR QË MBYLLET MË 31.12.2022**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit” e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

- 1. Miratimin e audituesit ligjor “Holly & Endi Auditing” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2022.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**